

STATUTI DHE AKT THEMELIMI
I
SHOQERISË ME PERGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“BEMARG38” Sh.p.k.

KREU I
THEMELIMI, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

Neni. 1 – Themelimi

Sot me datë 31/10/2021 (dymijë e njëzet e një), në mbështetje të Legjislacionit Shqiptar, respektivisht të Ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjit nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit”, themeluesit e përcaktuar si më poshtë kanë krijuar një Shoqëri Tregtare me emërtimin “BEMARG38” Sh.p.k dhe emërtim tregtar “BEMARG38” Sh.p.k, si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të së drejtës Shqiptare me,

Ortak Themelues,

Z. Arben XHAFERRI, i biri i Ejup, shtetas Shqiptar, lindur më 04 dhjetor 1962, me vendbanim ne Tiranë, Shqipëri, mbajtes i letërnjoftimit me nr.033351047 dhe nr personal ID G21204022U.

Neni 2 – Emërtimi

2.1 Emërtimi i Shoqërisë është **“BEMARG38” Sh.p.k.**

Neni 3 – Objekti

3.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi, si më poshtë:

- Aktivitete në fushën e ndërtimit, zbatimit, projektimit dhe rikonstruksioneve.
- Ndërtime civile dhe ekonomike, ndertime rruge, ndërtime hekurudhore, ndërtime elektrike, ndërtime ura dhe vepra arti, ndërtime hidraulike, restaurime etj.
- Prodhim dhe tregtim i materialeve të ndërtimit. Tregtim me shumicë dhe pakicë inerte dhe materiale të tjera ndërtimi.
- Ndërtim, rikonstruksion dhe mirëmbajtje godina civile dhe industriale, izolim dhe veshje fasadave.
- Ndërtim dhe mirmbajtje e linjave teknologjike etj.
- Shërbime konsulence dhe të ngjashme në ndërtim, rikonstruksion, menaxhim projektesh etj.
- Punime prishje e ndërtimeve, gërmime, punime rifiniture të muraturës dhe të tjera të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastic, metalik dhe xhami.
- Ndërtime parafabrikat, betonarme, truktura metalike dhe druri.
- Ndërtim dhe sherbimim mirembajtjeje i impianteve ngritese dhe transportues (ashensore, shkalle lëvizëse, transportuese etj).
- Ndërtim ujesjellesa, vepra kullimi dhe vaditje.
- Ndërtim dhe sherbim mirembajtjeje i impianteve të ujit të pijshem dhe pastrimit të tij.
- Ndërtim dhe mirëmbajtjeje i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane.
- Ndërtimi dhe mirëmbajtjeje i sistemeve kundra zhurmes per infrastrukturen.

- Ndërtim i objekteve të ndryshme për banim, të atyre social-kulturore, hapje rrugesh, asfaltime, ngritje fabrikash, hotelesh, aeroportuale etj.
- Ndërtim i linjave të prodhimit dhe përpunimit të cimentos dhe produkteve të ngjashme.
- Ndërtim hidrocentralesh për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.
- Ndërtim dhe mirëmbajtje të impianteve teknologjike, termike dhe kondicionimi.
- Ndërtim dhe mirëmbajtje të impianteve të sinjalistikës ndricuese të trafikut rrugor. Ndërtim dhe mirëmbajtjen e impianteve dhe linjave telefonike dhe telekomunikacionit. Ndërtim, rikonstruksion dhe mirëmbajtje të impianteve të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV etj.
- Ndërtim dhe mirëmbajtje të linjave teknologjike të survejimit dhe monitorimit kompjuterik. Punime germimi në tokë.
- Punime nëntokesore, ura e vepra arti. Diga dhe tunele hidroteknike.
- Ujësjetësia, gazsjetësia, vajsjetësia, vepra kullimi e vaditje.
- Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë.
- Përfaqësimin e shoqërive të ndryshme, Shqiptare dhe të huaja, që kanë objekt të njëjtë apo të ngjashëm me atë të kësaj shoqërie.

Neni 4 – Selia

- 4.1 Selia kryesore e Shoqërisë është në *Njesia nr.10, Rr. Shyqyri Berxholli, Kati 2, Nr. pasurie /472+2-9, Tiranë.*
- 4.2 Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si dhe jashtë saj, në përpundje me Legjislacionin përkatës të vendeve ku ato hapen.
- 4.4 Numri i kontaktit të Shoqërisë është +355 672031199 dhe adresa e postës elektronike bemarg.shpk@gmail.com

Neni 5 – Kohëzgjatja

- 5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë “BEMARG38” Sh.p.k do të jetë me një afat të pacaktuar.
- 5.2 Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

KREU II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6 – Kapitalit Themeltar

- 6.1 Kapitali Themeltar i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar është 100.000 (njëqind mijë) lek dhe është i ndarë në 1 (një) kuota. Themeluesit marrin në pronësi kuotat e tyre në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tyre.

Neni 7 – Kontributet

7.1 Kontributi në kapitalin themeltar të Shoqërisë është ofruar si më poshtë :

- **Arben XHAFERRI** ka ofruar një kontribut në para të barabartë me 100.000 (njëqind mijë) Lek, nëpërmjet depozitimit pranë njëres prej bankave të nivelit të dytë në Shqipëri, në favor të shoqërisë “BEMARG38” Sh.p.k.

7.2 Sipas kontributeve të mësipërme:

- **Arben XHAFERRI** i përket (një) kuotë, që i korrespondon 100% të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar

8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblese së Ortakëve.

8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjere proporcionalisht me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblese së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 10 – Transferimi i kuotave

10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakeve.

10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shperblim ashtu edhe pa shperblim në kuptimin më të gjërë të fjalës, duke përfshirë ketu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet me pare t'i ofrohen ne parabletje ortakeve te tjere.

10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftojë ortakët e tjere, me leter rekomande me kthim pergjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e bleresit dhe afatet e transferimit. E drejta e parabletjes duhet t'i referohet të gjitha kuotave të ofruar per shitje.

10.4 Ortakët do t'q kenq nq dispozicion 15 (pesqmbedhjetq) ditq nga marrja e letrqs rekomande, per t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre per të ushtuar apo jo të drejtën e parabletjes. Në rast se ata nuk pergjigjen ne afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.

10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortake, kuotat e ofruara nga ortaku qe transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtroje pjesërisht të drejtën e parabletjes.

10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parabletjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblese se Ortakeve.

10.7 Në rast të transferimit të kuotave për shkak të trashëgimit *mortis causa* ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Në rast se nuk jepet pëlqimi, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblese së Ortakeve.

KREU III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABEL

Neni 11 – Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakeve.

11.2 Asambleja e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimi e shkarkimi i Këshillit të Administrimit, eksperteve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër të parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkatës.

Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron.

12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.

12.3 Ortaku mund të lëshojë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

Neni 13 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet

13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratmit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.

13.2 Asambleja e Ortakëve thirret në çdo moment nga një prej Administratoreve si dhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve në adresën që rezulton në Librin e Ortakeve dhe ekspertit kontabel (nëse është emëruar), të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.

13.3 Në rast se Asambleja e Ortakeve nuk mbledhet me thirrjen e parë për mungesën e kuorumi të parashikuar në pikeën 13.6 të këtij Statuti, Asambleja e Ortakëve do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.

13.4 Mbledhjet e Asamblese mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të

ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.

13.5 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortaket që përfaqësojnë të gjithë kapitalin themeltar.

13.6 Vendimet e Asamblese së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortaket me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblese së Ortakëve që kërkojnë një shumicë të cilesuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortaket me të drejtë vote që zotërojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar.

13.7 Asambleja e Ortakëve vendos ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, transferimin e kuotave, shpërdarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro të 3/4 (tre të katërtat) e ortakëve të pranishëm që zotërojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakëve merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të ortakëve që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar.

13.8 Çdo Asamble drejtohet nga një Ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.

13.9 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

Neni 14 – Administrimi

14.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve emëron një person fizik si asministrator të vetëm të Shoqërisë për 5 (pesë) vjet sipas Nenit 81, paragrafi (1) pika dhe Neni 95 të Ligjit Nr.9901 të datës 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare*". Emërimet i nënshtrohen individualisht një vendimi me votën pro të shumicës së zakonshme, të kapitalit themelues, nëse miratohet, çon në zgjidhjen e personit të propozuar si Administrator.

14.2 Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorit parashikohen në Nenin 95, paragrafi (2) të Ligjit.

14.3 Shoqëria do të administrohet nga Administratori i cili do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkim apo doreheqje ose për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh:

- **Z.Arben XHAFERRI**, i biri i Ejup, shtetas Shqiptar, lindur më 04 dhjetor 1962, me vendbanim në Tiranë, Shqipëri, mbajtes i letërnjoftimit me nr.033351047 dhe nr personal ID G21204022U.

14.4 Veprimtaria tregtare e shoqëritë menaxhohet nga Administratori, i cili mund të ushtrojë të gjitha kopetencat e Shoqërisë që nuk i janë rezervuar Asamblesë së Përgjithshme nga Neni 81, paragrafi (6) i Ligjit.

14.5 Administratori/ët ka këto të drejta dhe detyrime:

a) të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

- b) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) të krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) të kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) të raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori/ët janë të detyruar të therasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 – Përgjegjësitë e Administratorit

15.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose

solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

16.2 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

16.3 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

16.4 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjëndjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 16 – Skualifikimi dhe largimi i Administratorit

16.1 Posti i Administratorit lirohet kur:

1. Pushon së qëni Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit, përfshirë Nenin-95 paragrafi (6).
2. Hyn në procedurën e paaftësisë paguese.
3. Vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. Jep dorëheqjen përmes një njoftimi që mund t'i bëjë Shoqërisë, ose
5. Ka munguar për më shumë se 3 muaj rradhazi pa leje në aktivitetin e përditshëm të Shoqërisë, ose Asambleja e Përgjithshme me propozim të Ortakëve të tjerë vendosin ta lirojnë nga detyra.

Neni 17 – Eksperti Kontabël i Autorizuar

17.1 Në rast se kërkohet nga Ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa eksperteve kontabël të autorizuar.

17.2 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gje të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

17.3 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të

ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorezohë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtes vendimore që ka.

17.4 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislati në fuqi

KREU IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 18 – Viti financiar dhe bilanci vjetor

18.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.

18.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

18.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare*”.

18.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 19 – Fitimet

19.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjeset e kapitalit themeltar të zotëruara.

19.2 Asamblej mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

KREU V

SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Neni 20 – Prishja

20.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga Ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.

20.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të Ortakëve.

Neni 21 – Likuidimi

21.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.

21.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjëndjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

21.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

21.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjeset e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 22 - Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

22.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 23 – Zgjidhja e mosmarreveshjeve

23.1 Të gjitha mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (perveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo me shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyre miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë te drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

23.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarreveshjes, ato do t’i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 24 – Dispozita të përgjithshme

24.1 Përsa i përket çështjeve që nuk janë të parashikuara në këtë Statut, do të aplikohen dispozitat e Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuara sipas Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”.

Neni 25 – Dispozita përfundimtare

25.1 Ky Statut përpilohet në 3 (tre) kopje origjinale, me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe, njëri prej të cilëve do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Statuti mbyllet me 25 (njëzet e pesë nene). Ky statut do të hyjë në fuqi menjëherë me regjistrimin e tij në QKB.

Lexuar, miratuar dhe nënshkruar.

**ORTAKU I VËTËM I SHOQËRISË
“BEMARG38” SH.P.K**


Arben XHAFERRI